REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
USTAVNI SUD
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 28 maj 2026
Nr. ref.:AGJ 3099/26

AKTGJYKIM

në

rastin nr. KI341/25

Parashtrues

Argjente Shehu

Vlerësim i kushtetutshmërisë së mosekzekutimit të Aktgjykimit [C.nr.501/13] të 18 dhjetorit 2013, të Gjykatës Themelore në Gjakovë

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Nexhmi Rexhepi, kryetar
Safet Hoxha, zëvendëskryetar
Bajram Ljatifi, gjyqtar
Radomir Laban, gjyqtar
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare
Enver Peci, gjyqtar dhe
Jeton Bytyqi, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është parashtruar nga Argjente Shehu, me vendbanim në Komunën e Gjakovës (në tekstin e mëtejmë: parashtruesja e kërkesës), e përfaqësuar nga Teki Bokshi, avokat në Komunën e Gjakovës.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesja e kërkesës konteston kushtetutshmërinë e mosekzekutimit të Aktgjykimit [C.nr.501/13] të 18 dhjetorit 2013 të Gjykatës Themelore në Gjakovë, Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni Civil (në tekstin e mëtejmë: Gjykata Themelore), i cili u bë i plotfuqishëm nëpërmjet Aktgjykimit [AC.nr.3260/2014] të 29 shtatorit 2014 të Gjykatës së Apelit të Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata e Apelit).

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes së kërkesës është vlerësimi i kushtetutshmërisë së mosekzekutimit të Aktgjykimit [C.nr.501/13] të 18 dhjetorit 2013 të Gjykatës Themelore, përmes të cilit parashtruesja e kërkesës pretendon se i janë shkelur të drejtat dhe liritë themelore të saj të garantuara me nenet 22 [Zbatimi i drejtpërdrejtë i Marrëveshjeve dhe Instrumenteve Ndërkombëtare] dhe 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta), si dhe nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejmë: KEDNJ).

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në paragrafët 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, në nenet 22 (Procedimi i kërkesës) dhe 47 (Kërkesa individuale) të Ligjit nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Ligji), si dhe në rregullin 25 (Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve) të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

5. Më 27 tetor 2025, parashtruesja e kërkesës, përmes postës elektronike, e dorëzoi kërkesën e saj në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata), të cilën Gjykata e pranoi më 28 tetor 2025.

6. Më 12 nëntor 2025, Kryetari i Gjykatës, përmes Vendimit [Nr. GJR. KI341/25], caktoi gjyqtaren Remzije Istrefi-Peci gjyqtare raportuese, dhe përmes Vendimit [Nr. KSH. KI341/25], caktoi Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Nexhmi Rexhepi (kryesues), Enver Peci dhe Jeton Bytyqi (anëtarë).

7. Më 21 nëntor 2025, Gjykata e njoftoi parashtruesen e kërkesës për regjistrimin e kërkesës.

8. Më 9 janar 2025, parashtruesja e kërkesës parashtroi informata shtesë në Gjykatë.

9. Më 29 janar 2026, Gjykata e njoftoi Gjykatën Themelore për regjistrimin e kërkesës, si dhe i kërkoi informatat për veprimet e ndërmarra në lidhje me: (i) zbatimin e Aktgjykimit [C. nr. 501/13] të 18 dhjetorit 2013 të Gjykatës Themelore; si dhe (ii) revokimin e kushtit ndaj debitorit, bazuar në Aktgjykimin [P. nr. 611/15] të 5 majit 2016, të Gjykatës Themelore.

10. Më 20 shkurt 2026, Gjykata Themelore i ktheu përgjigje Gjykatës në shkresën e saj të 29 janarit 2026.

11. Më 12 maj 2026, Kolegji shqyrtues e shqyrtoi raportin e gjyqtares raportuese dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës pranueshmërinë e kërkesës. Në të njëjtën ditë, Gjykata, njëzëri vendosi që: (i) ta deklarojë kërkesën të pranueshme; (ii) të konstatojë që ka pasur shkelje të paragrafit 2 të nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe paragrafit 1 të nenit 6 (E drejta për proces të rregullt) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, përkitazi me mosekzekutimin e Aktgjykimit [C.nr.501/13] të 18 dhjetorit 2013 të Gjykatës Themelore në Gjakovë; dhe (iii) të urdhërojë Gjykatën Themelore të ndërmarrë veprimet e nevojshme për të ekzekutuar Aktgjykimin [C.nr.501/13] të 18 dhjetorit 2013.

Përmbledhja e fakteve

(i) Procedura e alimentacionit

12. Nga shkresat e lëndës rezulton se më 1 prill 2010, Qendra për Punë Sociale në Gjakovë – Organi i Kujdestarisë (në tekstin e mëtejmë: QPS), përmes Aktvendimit [nr. 1487/10], ia kishte besuar në ruajtje, mbajtje dhe edukim parashtrueses së kërkesës djalin e saj të mitur, P.D.

13. Në një datë të paspecifikuar, djali i parashtrueses së kërkesës, i përfaqësuar nga vetë ajo, respektivisht nëna e tij, parashtroi padi për detyrim për pagesën e kontributit për mbajtje dhe ushqim kundër babait të tij, Sh.D.

14. Në një datë të paspecifikuar, babai i djalit të parashtrueses së kërkesës (në tekstin e mëtejmë: debitori) parashtroi përgjigje në padi.

15. Më 18 dhjetor 2013, Gjykata Themelore, përmes Aktgjykimit [C. nr. 501/13], aprovoi pjesërisht kërkesëpadinë e djalit të parashtrueses së kërkesës, P.D., dhe detyroi debitorin, Sh.D., që këtij të fundit t'ia paguajë shumën prej 80 (tetëdhjetë) euro çdo muaj në emër të kontributit për mbajtje dhe ushqim, nga data 1 e muajit rrjedhës për muajin paraprak, duke filluar nga data 1 mars 2013 e tutje, derisa të ekzistojnë kushtet ligjore.

16. Në një datë të paspecifikuar, debitori parashtroi ankesë kundër Aktgjykimit [C. nr. 501/13] të 18 dhjetorit 2013 të Gjykatës Themelore.

17. Më 29 shtator 2014, Gjykata e Apelit, përmes Aktgjykimit [Ac. nr. 3260/2014], e refuzoi ankesën e debitorit dhe e vërtetoi Aktgjykimin [C. nr. 501/13] e 18 dhjetorit 2013 të Gjykatës Themelore, me ç'rast Aktgjykimi [C. nr. 501/13] u bë i formës së prerë.

(ii) Procedurat përmbarimore dhe penale

18. Më 20 nëntor 2014, parashtruesja e kërkesës në cilësinë e përfaqësueses ligjore të kreditorit të mitur, parashtroi në Gjykatën Themelore propozim për përmbarim në mjete monetare sipas bazës së ushqimisë, duke u bazuar në Aktgjykimin [C. nr. 501/13] të 18 dhjetorit 2013 të Gjykatës Themelore, i cili kishte marrë formë të prerë më 29 shtator 2024.

19. Më 25 shtator 2015, Prokuroria Themelore në Gjakovë, përmes Aktakuzës [PP. Nr. 548/2015], akuzoi debitorin për kryerjen e veprës penale "*Shmangia nga sigurimi i mjeteve të jetesës*" nga paragrafi 3 i nenit 252 (Shmangia nga sigurimi i mjeteve të jetesës) të Kodit Nr. 04/L-082 Penal të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: KPRK), duke qenë se i njëjti nuk ia

kishte paguar djalit të tij shumën prej 80 (tetëdhjetë) euro në muaj, ashtu siç ishte përcaktuar në Aktgjykimin e plotfuqishëm të Gjykatës Themelore, respektivisht Aktgjykimin [C. nr. 501/13] e 18 dhjetorit 2013.

20. Më 5 maj 2016, Gjykata Themelore në Gjakovë – Departamenti për të Mitur, përmes Aktgjykimit [P. Nr. 611/15] (i) e shpalli fajtor debitorin për kryerjen e veprës penale "*Shmangia nga sigurimi i mjeteve të jetesës*" nga paragrafi 3 i nenit 252 të KPPRK-së dhe e dënoi me kusht, ashtu që të njëjtit i shqiptoi dënim me burgim me kohëzgjatje prej 180 (njëqind e tetëdhjetë) ditësh, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse debitori, brenda kohës së verifikimit prej 1 (një) viti, i përmbush obligimet e përcaktuara në Aktgjykimin e plotfuqishëm të Gjykatës Themelore, respektivisht Aktgjykimin [C. nr. 501/13] e 18 dhjetorit 2013; si dhe (ii) udhëzoi të dëmtuarin, respektivisht parashtruesen e kërkesës që ta realizojë kërkesën pasurore-juridike në kontest civil.

21. Në një datë të paspecifikuar, debitori parashtroi ankesë kundër Aktgjykimit [P. Nr. 611/15] të 5 majit 2016 të Gjykatës Themelore në Gjakovë – Departamenti për të Mitur.

22. Më 27 korrik 2016, Gjykata e Apelit, përmes Aktvendimit [PAM. Nr. 47/2016], e hodhi poshtë si të palejuar ankesën e debitorit, duke u bazuar në paragrafin 2 të nenit 382 (Përmbajtja e ankesës kundër aktgjykimit) të Kodit Nr. 04/L-123 të Procedurës Penale të Kosovës (në tekstin e mëtejmë: KPPRK).

23. Më 30 gusht 2017, parashtruesja e kërkesës, në cilësinë e të dëmtuarës, paraqiti kërkesë për revokimin e dënimit me kusht sipas Aktgjykimit [P. Nr. 611/15] të 15 shtatorit 2015 të Gjykatës Themelore në Gjakovë – Departamenti për të Mitur, i cili kishte marrë formë të prerë më 27 korrik 2016, pasi që debitori nuk i kishte paguar djalit të parashtrueses së kërkesës (të miturit) shumën prej 80 (tetëdhjetë) eurosh, ashtu siç përcaktohej në dënimin me kusht në po të njëjtin aktgjykim.

24. Më 17 shtator 2025, parashtruesja e kërkesës, në cilësinë e të dëmtuarës, përsëriti kërkesën e lartcekur për revokimin e kushtit sipas Aktgjykimit [P. Nr. 611/15] të 15 shtatorit 2015 të Gjykatës Themelore në Gjakovë – Departamenti për të Mitur.

Pretendimet e parashtrueses së kërkesës

25. Parashtruesja e kërkesës pretendon se me mosekzekutimin e Aktgjykimit [C. nr. 501/13] të 18 dhjetorit 2013 të Gjykatës Themelore, asaj i janë shkelur të drejtat e garantuara me nenet 22 dhe 31 të Kushtetutës, si dhe nenin 6 të KEDNJ-së.

26. Parashtruesja e kërkesës, në thelb, kërkon përmbarimin e Aktgjykimit [C. nr. 501/13] të 18 dhjetorit 2013 të Gjykatës Themelore, respektivisht ekzekutimin e alimentacionit nga ana e debitorit për djalin e tyre në shumën prej 80 (tetëdhjetë) euro në muaj prej 1 marsit 2013 e tutje.

27. Parashtruesja e kërkesës konsideron se: "*Gjykata Themelore në Gjakovë ka dështuar të ndërmarrë veprime konkrete në një çështje me natyrë urgjente për më shumë se një dekadë, duke mos garantuar zbatimin e një aktgjykimi të formës së prerë dhe duke shkelur rëndë të drejtën e kërkuesit - të miturit - për të marrë ushqimin ekzistencial*". Në këtë kontekst, ajo nënvizon se rasti në fjalë nuk ka të bëjë me një kontest civil të zakonshëm, por prek të drejtën themelore të jetës dhe mirëqenies së një të mituri, respektivisht mospërmbarimin e një borxhi

11 (njëmbëdhjetë) vjeçar që ndërlidhet me pagesën e alimentacionit si çështje *"jetike"* që kërkon trajtim urgjent dhe *ex-officio* nga gjykatat, ashtu siç përcaktohet me nenin 6 (Urgjenca dhe rendi i veprimit) të Ligjit Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbarimore (në tekstin e mëtejmë: LPP).

28. Parashtruesja e kërkesës, në kërkesën e saj, gjithashtu thekson se: "*Mosveprimi i gjykatës për një periudhë të gjatë përbën zvarritje të pajustifikuar të procedurës përmbarimore dhe penale, e cila cenon seriozisht parimin kushtetues të gjykimit në afat të arsyeshëm dhe e bën të paefektshëm vendimin gjyqësor duke e zhveshur atë nga fuqia ekzekutive që i takon me ligj"*. Po ashtu, parashtruesja e kërkesës numëron konventat ndërkombëtare që janë drejtpërdrejt të zbatueshme në Kosovë, siç është Konventa për të Drejtat e Fëmijës (në tekstin e mëtejmë: KDF), e cila obligon shtetin dhe gjykatat që në çdo rast që përfshin të mitur, të vendosin në përputhje me interesin më të mirë të fëmijës ("*Best interest of the child*").

29. Parashtruesja e kërkesës, po ashtu, përmend disa aktgjykime nga praktika gjyqësore e Gjykatës, që ndërlidhen me shkeljen e të drejtës për gjykim brenda një afati të arsyeshëm, si dhe praktikën e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejmë: GJEDNJ) përkitazi me mosekzekutimin e aktgjykimeve të plotfuqishme.

30. Në fund, parashtruesja e kërkesës kërkon nga Gjykata që, në emër të kompensimit të dëmit jomaterial për shkak të dhimbjeve shpirtërore si pasojë e shkeljes së të drejtave të njeriut, t'ia ndajë shumën prej 10,000 (dhjetë mijë) eurosh.

Informacionet shtesë të paraqitura nga parashtruesja e kërkesës më 9 janar 2025

31. Më 9 janar 2025, parashtruesja e kërkesës, me qëllim të mbështetjes së kërkesës së saj, e informoi Gjykatën se e njëjta kishte vendosur në një situatë të ngjashme faktike dhe juridike, me ç'rast kishte aprovuar kërkesën e palës për moszbatim të një aktgjykimi nga lëmia e punës, respektivisht Aktgjykimi në rastin KI205/25 (parashtruese *SH.A.M*, Aktgjykim i 19 nëntorit 2025).

Përgjigja e Gjykatës Themelore e 20 shkurtit 2026

32. Siç është cekur edhe më lart, më 20 shkurt 2026, Kryetarja e Gjykatës Themelore i ktheu përgjigje Gjykatës në shkresën e 29 janarit 2026, në të cilën kjo e fundit ia kërkoi informatat për veprimet e ndërmarra në lidhje me: (i) zbatimin e Aktgjykimit [C. nr. 501/13] të 18 dhjetorit 2013 të Gjykatës Themelore; si dhe (ii) revokimin e kushtit ndaj debitorit bazuar në Aktgjykimin [P. nr. 611/15] e 5 majit 2016 të Gjykatës Themelore.

33. Përkitazi me zbatimin e Aktgjykimit [C. nr. 501/13] të 18 dhjetorit 2013, Gjykata Themelore e njoftoi Gjykatën si në vijim:

> *"- Gjyqtari i çështjes është ngarkuar me këtë lëndë sipas vendimit të ish-UD. Kryetares së Gjykatës, znj. B.D., me datë 08.07.2025, së bashku me një numër të konsiderueshëm lëndësh të tjera të natyrave të ndryshme.*
> *- Nga shkresat e lëndës rezulton se kreditori P.D., i përfaqësuar nga përfaqësuesja ligjore [A.Sh. – parashtruesja e kërkesës] nga Gjakova, me datë 12.12.2014, ka paraqitur Propozim për Përmbarim kundër debitorit Sh.D., në bazë të titullit përmbarimor – Aktgjykimit C.nr.501/13, i plotfuqishëm nga data 29.09.2014, për realizimin e detyrimit të rrjedh nga alimentacioni.*

- Me datë 12.12.2014, gjykata ka lejuar përmbarimin sipas propozimit të kreditorit.
- Me parashtresën e datës 22.09.2025, përfaqësuesi i kreditorit ka kërkuar trajtim me prioritet të lëndës dhe ka propozuar marrjen e provës me ekspertizë financiare për qëllim të përcaktimit të saktë të shumës së detyrimit.
- Gjykata, me Aktvendimin CP.nr.1412/14 të datës 15.10.2025, ka aprovuar propozimin për marrjen e provës me ekspertizë financiare.
- Ekspertiza financiare është dorëzuar në gjykatë me datë 19.12.2025 dhe e njëjta u është dorëzuar palëve, përkatësisht përfaqësueses së kreditorit me datë 23.12.2025 dhe debitorit me datë 19.01.2026.
Me datë 05.01.2026, përfaqësuesi i kreditorit ka bërë precizimin e propozimit për përmbarim në pajtim me gjetjet e ekspertizës, ndërsa i njëjti i është dorëzuar debitorit, i cili e ka pranuar me datë 19.01.2026.
- Me datë 23.01.2026, debitori ka paraqitur kundërshtim lidhur me vlerën dhe bazën juridike të kërkesës, duke pretenduar se kreditori nuk ka qenë palë në procedurën fillestare dhe se duhet të iniciohet procedurë e re.
- Ky kundërshtim i është përcjellë përfaqësueses ligjore të kreditorit, e cila e ka pranuar me datë 30.01.2026.
- Gjykata, me datë 06.02.2026, në bazë të precizimit të propozimit të datës 05.01.2026, ka nxjerrë aktvendim për bllokimin e llogarive bankare të debitorit.
- Sipas informatave të marra nga referentja e përmbarimeve, rezulton se llogaritë bankare të debitorit veçse janë të bllokuara.
- Gjykata vëren se në propozimin për përmbarim është kërkuar realizimi i përmbarimit përmes sekuestrimit të mjeteve monetare të debitorit pranë bankave përkatëse dhe transferimin e tyre në dobi të kreditorit."

34. Përkitazi me veprimet e ndërmarra në lidhje me revokimin e kushtit ndaj debitorit, bazuar në Aktgjykimin [P. nr. 611/15] e 5 majit 2016 të Gjykatës Themelore, Gjykata Themelore e njoftoi Gjykatën si në vijim:

"[...]
- E dëmtuara A. Sh. [parashtruesja e kërkesës] me datën 30.08.2017, ka parashtruar propozim për revokimin e dënimit me kusht, duke theksuar se i akuzuari nuk ka vepruar fare, nuk ka paguar shumën prej 80 euro nga data 01.03.2013 e tutje.
- Nga shkresat e lëndës vërtetohet se gjykata ka vepruar sipas kërkesës të dëmtuarës për revokimin e dënimit me kusht, është mbajtur seanca dëgjimore me datën 28.08.2018, është njoftuar i gjykuari se aktgjykimi është bërë i plotfuqishëm me datën 27.07.2016, ku është shpallur fajtor dhe i është shqiptuar dënimi me kusht. I gjykuari e ka pranuar se në bazë të Aktgjykimit C.nr.501/13 të datës 18.12.2013 është obliguar të paguajë shumën prej 80 Euro të dëmtuarës nga data 01.03.2013 e tutje, mirëpo nuk është marrë vendim për revokimin e dënimit me kusht.
- Sërish me datën 17.09.2025, është parashtruar kërkesa për revokim të dënimit me kusht me datën 31.10.2025, është mbajtur seanca dëgjimore lidhur me këtë kërkesë dhe Kolegji i gjykatës ka vendosur me aktvendimin PK. Nr. 14/26 me datën 09.02.2026, ku është konstatuar se propozimi për revokim të dënimit me kusht ka qenë 1 vit nga dita e plotfuqishmërisë, konkretisht deri më datën 27.07.2017 (kërkesa e parë me datë 30.08.2017, ndërsa kërkesa e dytë me 17.09.2025), rrjedhimisht është paraqitur pas afatit ligjor dhe për këtë arsye është konsideruar si e pabazuar."

Dispozitat përkatëse kushtetuese dhe ligjore

Kushtetuta e Republikës së Kosovës

Neni 31
[E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm]

1. *"Çdokujt i garantohet mbrojtje e barabartë e të drejtave në procedurë para gjykatave, organeve të tjera shtetërore dhe bartësve të kompetencave publike.*
2. *Çdokush gëzon të drejtën për shqyrtim publik të drejtë dhe të paanshëm lidhur me vendimet për të drejtat dhe obligimet ose për cilëndo akuzë penale që ngrihet kundër saj/tij brenda një afati të arsyeshëm, nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e themeluar me ligj."*

Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut

Neni 6
(E drejta për një proces të rregullt)

"1. Çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e krijuar me ligj, e cila do të vendosë si për mosmarrëveshjet në lidhje me të drejtat dhe detyrimet e tij të natyrës civile, ashtu edhe për bazueshmërinë e çdo akuze penale në ngarkim të tij."

Ligji nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbarimore

Neni 6
(Urgjenca dhe rendi i veprimit)

"1. Në procedurën e përmbarimit organi përmbarues ka për detyrë të veprojë me ngutshmëri.
2. Organi përmbarues ka për detyrë që lëndët t'i marrë në punë sipas radhës që i ka pranuar, përpos kur natyra e kredisë ose rrethanat e posaçme kërkojnë që organi përmbarues të veprojë ndryshe.
3. Organi përmbarues mund të konkludojë se natyra e kredisë kërkon trajtim të përshpejtuar të rastit nëse ka rrezik legjitim që pasuritë e debitorit në atë rast të mos jenë në dispozicion për konfiskim apo do t'i bie vlera shumë në rast të vonesës. Gjyqtari mund të pranojë ekzistimin e rrethanave të veçanta, dhe të veprojë shpejt, në rastet që kanë të bëjnë me punësimin, çështjet familjare, alimentacionin apo pagesat për fëmijë nëse interesat e palës mund të ndikohen negativisht si rezultat i vonesës."

Kodi Nr. 04/L-082 Penal i Republikës së Kosovës

Neni 252
(Shmangia nga sigurimi i mjeteve të jetesës)

"1. Kushdo që i shmanget sigurimit të mjeteve të jetesës për personin për të cilin është i detyruar të kujdeset në bazë të vendimit të plotfuqishëm të gjykatës, marrëveshjes së plotfuqishme gjyqësore ose vendimit të organit tjetër kompetent, me anë të shmangies së punësimit, raportimit të rrejshëm të punësimit apo të të ardhurave, ndërrimit të vendit të punës, ndërrimit të vendbanimit apo vendqëndrimit, tjetërsimit të pasurisë

ose në ndonjë mënyrë tjetër i shmanget sigurimit të mjeteve të jetesës për personin e tillë, dënohet me burgim deri në një (1) vit.
[...]
3. Kur vepra penale nga paragrafi 1. i këtij neni ka të bëjë me fëmijën kryesi dënohet me burgim prej tre (3) muaj deri në tre (3) vjet.
4. Nëse gjykata shqipton dënimin me kusht, ajo mund të urdhërojë si kusht që kryesi rregullisht t'i përmbush detyrimet e tij të sigurimit të mjeteve të jetesës dhe të paguajë detyrimet e papaguara.
5. Nëse kryesi i veprës penale nga paragrafi 1. i këtij neni i përmbush detyrimet para se gjykata të shqiptojë aktgjykimin, gjykata mund ta lirojë nga dënimi."

Kodi Nr. 04/L-123 i Procedurës Penale

Neni 382
(Përmbajtja e ankesës kundër aktgjykimi)

"[...]
3. Në ankesë mund të paraqiten fakte dhe prova të reja, por ankuesi detyrohet të arsyetojë përse ato nuk i ka paraqitur më parë. Kur ankuesi thirret në fakte të reja, ai detyrohet të paraqesë prova me të cilat këto fakte mund të provohen, e kur u referohet provave të reja, detyrohet të paraqesë faktet që ai synon t'i vërtetojë me to
[...]".

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

35. Gjykata së pari shqyrton nëse parashtruesja e kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë, të parashikuara me Ligj dhe të specifikuara më tej me Rregullore të punës.

36. Në këtë drejtim, Gjykata u referohet paragrafëve 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, të cilët përcaktojnë:

"1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para Gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.
[...]
7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj".

37. Gjykata gjithashtu shqyrton nëse parashtruesja e kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, siç përcaktohet me Ligj. Në lidhje me këtë, Gjykata u referohet neneve 47 (Kërkesa individuale), 48 (Saktësimi i kërkesës) dhe 49 (Afatet) të Ligjit, të cilët përcaktojnë:

Neni 47
(Kërkesa individuale)

"1. Çdo individ ka të drejtë të kërkojë nga Gjykata Kushtetuese mbrojtje juridike në rast se pretendon se të drejtat dhe liritë e tija individuale të garantuara me Kushtetutë janë shkelur nga ndonjë autoritet publik.

2. Individi mund të ngrejë kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj".

Neni 48
(Saktësimi i kërkesës)

"Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësojë saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj".

Neni 49
(Afatet)

"Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajve. Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor [...]".

38. Sa i përket përmbushjes së këtyre kritereve, Gjykata fillimisht thekson se parashtruesja e kërkesës është palë e autorizuar, e cila konteston mosekzekutimin e Aktgjykimit [C. nr. 501/13] të 18 dhjetorit 2013 të Gjykatës Themelore, i cili u bë i plotfuqishëm nëpërmjet Aktgjykimit [Ac. nr. 3260/2014] të 29 shtatorit 2014 të Gjykatës së Apelit. Parashtruesja e kërkesës gjithashtu ka qartësuar të drejtat dhe liritë që pretendon se i janë shkelur, në pajtim me kërkesat e nenit 48 të Ligjit, dhe ka dorëzuar kërkesën në pajtim me afatin e përcaktuar në nenin 49 të Ligjit, duke qenë se në rastin konkret kemi të bëjmë me pretendim për shkelje të vazhdueshme. Gjykata thekson se kërkesa e parashtrueses së kërkesës nuk është qartazi e pabazuar, sipas rregullit 34 (2) të Rregullores së punës dhe rrjedhimisht do të shqyrtohet në merita.

Meritat e kërkesës

39. Gjykata rikujton se parashtruesja e kërkesës është nëna dhe përfaqësuesja ligjore (nga 1 prilli 2010) e djalit të mitur P.D, i cili parashtroi padi për detyrim për pagesën e kontributit për mbajtje dhe ushqimi kundër babait të tij, respektivisht debitorit, në Gjykatën Themelore. Më 18 dhjetor 2013, Gjykata Themelore, përmes Aktgjykimit [C. nr. 501/13], miratoi kërkesëpadinë e djalit të parashtrueses së kërkesës dhe detyroi debitorin që t'ia paguajë alimentacionin në shumën prej 80 (tetëdhjetë) eurosh në muaj, duke filluar nga 1 marsi 2013 e derisa të ekzistojnë kushtet ligjore, i cili aktgjykim u bë i formës së prerë përmes Aktgjykimit [AC. nr. 3260/14] të 29 shtatorit 2014 të Gjykatës së Apelit. Pas kësaj, duke qenë se debitori nuk kishte paguar alimentacionin, më 20 nëntor 2014, parashtruesja e kërkesës kërkoi nga Gjykata Themelore përmbarimin e Aktgjykimit të lartcekur. Më 5 maj 2016, Gjykata Themelore, përmes Aktgjykimit [P. Nr. 611/15], e shpalli fajtor debitorin për veprën penale "*Shmangia nga sigurimi i mjeteve të jetesës*", të cilin e dënoi me kusht, ashtu që, në rast të mospagesës së alimentacionit sipas Aktgjykimit formës së prerë, do t'i shqiptohej dënimi me burgim prej 180 (njëqind e tetëdhjetë) ditësh, i cili aktgjykim u vërtetua nga Gjykata e Apelit, pasi që kjo e fundit hodhi poshtë ankesën e debitorit. Më 29 gusht 2017 dhe 17 shtator 2025, parashtruesja e kërkesës kërkoi nga Gjykata Themelore revokimin e kushtit sipas aktgjykimit penal, duke qenë se debitori ende nuk kishte kryer obligimin sipas Aktgjykimit [C. nr. 501/13] të 18 dhjetorit 2013 të Gjykatës Themelore.

40. Parashtruesja e kërkesës pretendon para Gjykatës se Aktgjykimi i Gjykatës Themelore nuk ishte zbatuar dhe, si pasojë, janë shkelur të drejtat e garantuara me nenet 22 dhe 31 të Kushtetutës, si dhe me nenin 6 të KEDNJ-së.

41. Në këtë kontekst, Gjykata vlerëson se pretendimet e parashtrueses së kërkesës duhet të vlerësohen në kuptim të së drejtës për një gjykim të drejtë të garantuar me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës, si dhe nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) të KEDNJ-së. Gjykata do të aplikojë standardet e praktikës gjyqësore të saj dhe ato të GJEDNJ-së, në harmoni me të cilën, në bazë të nenit 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] të Kushtetutës, ajo është e detyruar të interpretojë të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me Kushtetutë.

(i) Parimet e përgjithshme për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore

42. Gjykata rikujton se e drejta për një gjykim të drejtë, e garantuar me nenin 31 të Kushtetutës dhe nenin 6 të KEDNJ-së, përfshin, ndër të tjera, edhe të drejtën për të iniciuar para një tribunali një rast që ndërlidhet me të drejtat e obligimet civile, përkatësisht të drejtën për "*qasje në gjykatë*". Megjithatë, siç është theksuar në praktikën gjyqësore të Gjykatës dhe atë të GJEDNJ-së, e drejta në "*qasje në gjykatë*" do të ishte iluzore nëse sistemi juridik i një vendi do të lejonte që një vendim gjyqësor i plotfuqishëm të mbetej i paefektshëm në dëm të një pale (shih rastet e Gjykatës: KI175/19, *parashtrues Ismajl Zogaj*, Aktgjykim i 1 korrikut 2021, paragrafi 97, dhe KI205/25, parashtruese *SH.A.M*, Aktgjykim i 19 nëntorit 2025, paragrafi 46); dhe rastin e GJEDNJ-së *Hornsby kundër Greqisë*, nr. 18357/91, Aktgjykim i 19 marsit 1997, paragrafi 40).

43. Prandaj, Gjykata ka theksuar se përmbarimi i vendimit të formës së prerë konsiderohet pjesë përbërëse e të drejtës për gjykim të drejtë, e garantuar me nenin 31 të Kushtetutës dhe nenin 6 të KEDNJ-së (shih rastet e Gjykatës: KI175/19, *parashtrues Ismajl Zogaj*, Aktgjykim i 1 korrikut 2021, paragrafi 90; KI193/18, *parashtrues Agron Vula*, Aktgjykim i 22 prillit 2020, paragrafi 120; dhe rastin e GJEDNJ-së *Hornsby kundër Greqisë*, nr. 18357/91, Aktgjykim i 19 marsit 1997, paragrafi 40). Për më tepër, Gjykata ka theksuar se sundimi i ligjit, si një prej parimeve themelore të një shoqërie demokratike, presupozon edhe respektimin e parimit të sigurisë juridike, sidomos në lidhje me zbatimin e vendimeve gjyqësore që kanë marrë formë *res judicata* (shih rastet e Gjykatës: KI205/25, parashtruese *SH.A.M*, cituar më lart, paragrafi 47; dhe KI08/09, *parashtrues Sindikata e pavarur e punonjësve të Fabrikës së çelikut – IMF Ferizaj*, Aktgjykim i 17 dhjetorit 2010, paragrafi 62).

44. Në këtë kuptim, autoritetet kompetente kanë për obligim që të organizojnë një sistem efektiv për zbatimin e vendimeve në kuptimin ligjor dhe praktik, për të siguruar që zbatimi i vendimeve të bëhet pa vonesa të panevojshme. Përderisa, disa vonesa në zbatimin e vendimeve mund të justifikohen në rrethana të veçanta, të njëjtat në asnjë rast nuk duhet të jenë të tilla që të dëmtojnë thelbin e të drejtës së mbrojtur sipas nenit 6 të KEDNJ-së dhe nenit 31 të Kushtetutës. Megjithatë, arsyeshmëria e një vonese të tillë duhet të vlerësohet, duke marrë parasysh veçanërisht kompleksitetin e procedurave të zbatimit të vendimit, sjelljen e palës dhe atë të autoriteteve kompetente, si dhe atë që është në rrezik për palën në rastin konkret (shih rastet e Gjykatës: KI205/25, parashtruese *SH.A.M*, cituar më lart, paragrafi 48; dhe KI10/17, *parashtrues Sadije Shabani*, Aktgjykim i 13 nëntorit 2017, paragrafi 66; dhe rastin e GJEDNJ-së: *Peceve kundër Ish-Republikës Jugosllave te Maqedonisë*, nr. 21839/03, Aktgjykim i 6 nëntorit 2008, paragrafët 29-30).

45. Për më tepër, Gjykata thekson se kur një vendim është kundër shtetit, ky i fundit duhet të marrë nismën për ta zbatuar atë plotësisht dhe në kohë të duhur (shih rastin e GJEDNJ-së: *Akashev kundër Rusisë*, nr. 30616/05, Aktgjykim i 12 qershorit 2008, paragrafi 21). Ndryshe nga detyrimi i shtetit për t'iu përgjigjur shpejt vendimeve kundër saj, në fushën e zbatimit të

një vendimi përfundimtar dhe të detyrueshëm gjyqësor kundër një pale private, detyrimet e shtetit kufizohen në sigurimin e ndihmës ligjore të nevojshme për kreditorin dhe në garantimin e funksionimit efektiv të procedurës. Në ndërlidhje me kompensimin monetar, koha për llogaritjen e kohëzgjatjes së zbatimit të vendimit fillon nga momenti kur aktgjykimi është bërë i formës së prerë dhe i përmbarueshëm deri në momentin kur *kompensimi financiar paguhet për individin* (shih rastin e Gjykatës: KI205/25, parashtruese *SH.A.M*, cituar më lart, paragrafi 49; dhe rastin e GJEDNJ-së: *Burdov kundër Rusisë (no.2)* nr.33509/04, Aktgjykim i 15 janarit 2009, paragrafi 73).

(ii) Zbatimi i këtyre parimeve në rastin konkret

46. Gjykata rikujton se, më 18 dhjetor 2013, Gjykata Themelore, përmes Aktgjykimit [C. nr. 501/13], e miratoi si të bazuar padinë e djalit të mitur të parashtrueses së kërkesës dhe e detyroi debitorin që t'ia paguajë alimentacionin prej 80 (tetëdhjetë) eurosh në muaj që nga 1 marsi 2013 derisa të ekzistojnë kushtet ligjore. Aktgjykimi i Gjykatës Themelore u bë i formës së prerë përmes Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit. Gjykata vëren se, pavarësisht kërkesës së parashtrueses së kërkesës për përmbarim të Aktgjykimit të lartcekur, debitori nuk kishte paguar borxhin e tij, respektivisht alimentacionin, të paktën deri në parashtrimin e kërkesës së parashtrueses para Gjykatës më 27 tetor 2025.

47. Në rastin konkret, Gjykata thekson se shteti nuk është debitor dhe nuk mban përgjegjësi të drejtpërdrejtë për mosekzekutimin e aktgjykimit të formës së prerë të 18 dhjetorit 2013 të Gjykatës Themelore; dhe se debitori është një entitet privat. Megjithatë, Gjykata do të vlerësojë nëse masat e zbatuara nga autoritetet shtetërore në këtë rast ishin të përshtatshme dhe të mjaftueshme; dhe nëse vepruan në harmoni me standardet e lartcekura për të ndihmuar parashtruesen e kërkesës për ekzekutimin e Aktgjykimit në favor të djalit të saj të mitur (shih për këtë mënyrë të vlerësimit, rastin e Gjykatës: KI205/25, parashtruese *SH.A.M*., cituar më lart, paragrafi 52, si dhe rastet e GJEDNJ-së: *Zorislav Sekul kundër Kroacisë*, nr.3569/13, Vendim i 30 qershorit 2015, paragrafi 55; *Vasiliy Markovich Fomenko kundër Rusisë*, nr.42140/05, Vendim i 24 shtatorit 2019, paragrafi 181); dhe nëse kohëzgjatja e ekzekutimit të aktgjykimit të formës së prerë mund të konsiderohet e arsyeshme.

48. Gjykata rithekson se, më 20 nëntor 2014, parashtruesja e kërkesës kishte kërkuar përmbarimin e Aktgjykimit të formës së prerë të Gjykatës Themelore. Nga shkresat e lëndës së dorëzuar nga parashtruesja e kërkesës nuk rezulton se e Gjykata Themelore ka ndërmarrë veprime në drejtim të përmbarimit të këtij aktgjykimi. Megjithatë, Gjykata më 29 janar 2026 iu drejtua Gjykatës Themelore me pyetjen se a e ka zbatuar këtë aktgjykim. Nga përgjigja e Gjykatës Themelore, e dorëzuar në Gjykatë më 20 shkurt 2026, rezulton se më 12 dhjetor 2014, Gjykata Themelore kishte lejuar përmbarimin sipas propozimit të parashtrueses së kërkesës, ndërsa deri më 22 shtator 2025, kur kjo e fundit kishte kërkuar trajtim me prioritet të lëndës dhe marrjes së ekspertizës financiare, kjo gjykatë kishte qenë pasive. Më 15 tetor 2025, Gjykata Themelore kishte aprovuar propozimin e marrjes së ekspertizës financiare dhe kishte zhvilluar procedurën përmbarimore deri më 6 shkurt 2026, kur edhe bazuar në precizimin e 15 janarit 2026, nxori Aktvendimin për bllokimin e llogarive të debitorit, të cilat veçse janë bllokuar dhe pritet sekuestrimi i mjeteve monetare të debitorit pranë bankave përkatëse dhe transferimi i tyre në dobi të debitorit.

49. Në anën tjetër, Gjykata rikujton se, më 5 maj 2016, Gjykata Themelore e shpalli fajtor debitorin për veprën penale "*Shmangia nga sigurimi i mjeteve të jetesës*", të cilin e dënoi me kusht, ashtu që në rast të mospagesës së alimentacionit sipas Aktgjykimit formës së prerë të Gjykatës Themelore, do t'i shqiptohej dënimi me burgim prej 180 (njëqind e tetëdhjetë)

ditësh. Sipas përgjigjes së lartcekur të Gjykatës Themelore, përkitazi me pyetjen tjetër të Gjykatës në lidhje me veprimet e ndërmarra në lidhje me revokimin e kushtit ndaj debitorit bazuar në aktgjykimin penal, rezulton se Gjykata Themelore kishte mbajtur një seancë dëgjimore më 28 gusht 2018, ku debitori ishte njoftuar për dënimin me kusht, dhe obligimin për të përmbushur kushtin, por i njëjti nuk e kishte përmbushur të njëjtin dhe as Gjykata Themelore nuk kishte marrë vendim për revokim të tij. Duke qenë se më 17 shtator 2025, parashtruesja e kërkesës kishte parashtruar sërish kërkesën për revokim të kushtit (kërkesa e parë ishte parashtruar më 30 gusht 2017), Gjykata Themelore më 31 tetor 2025 kishte mbajtur një seancë dëgjimore, ku kishte konstatuar se propozimi për revokim të dënimit me kusht është i pabazuar, për faktin se koha e verifikimit të dënimit me kusht ka qenë 1 (një) vit nga dita e plotfuqishmërisë, konkretisht deri më 27 korrik 2017, ndërsa kërkesat për revokimin e dënimit me kusht, të paraqitura më 30 gusht 2017 dhe më 17 shtator 2025, janë paraqitur jashtë afatit ligjor. Pavarësisht moszbatimit në vazhdimësi të Aktgjykimit të formës së prerë nga ana e debitorit, Gjykata nënvizon se Gjykata Themelore nuk ka shqiptuar dënimin me burgim prej 180 (njëqind e tetëdhjetë) ditësh në përputhje me dispozitivin e Aktgjykimit [P. Nr. 611/15] të 5 majit 2016 të Gjykatës Themelore, i cili u bë i plotfuqishëm më 27 korrik 2016.

50. Që nga 29 shtatori 2014, kur Aktgjykimi [C. nr. 501/13] i 18 dhjetorit 2013 i Gjykatës Themelore u bë i formës së prerë përmes Aktgjykimit [Ac. nr. 3260/2014] të Gjykatës së Apelit, deri në parashtrimin e kërkesës para Gjykatës më 27 tetor 2025, kanë kaluar 11 (njëmbëdhjetë) vjet e 28 (njëzet e tetë) ditë. Ndërsa, që nga 27 korriku 2016, kur Aktgjykimi [P. Nr. 611/15] i 5 majit 2016 të Gjykatës Themelore u bë i formës së prerë përmes Aktgjykimit [PAM. Nr. 47/2016], me të cilin debitori u shpall fajtor për veprën penale "*Shmangia nga sigurimi i mjeteve të jetesës*", e deri në parashtrimin e kërkesës para Gjykatës më 27 tetor 2025, kanë kaluar 9 (nëntë) vjet e 3 (tre) muaj.

51. Në lidhje me urgjencën e përmbarimit të aktgjykimeve të plotfuqishme që ndërlidhen me çështjen e alimentacionit, Gjykata i referohet paragrafit 3 të nenit 6 (Urgjenca dhe rendi i veprimit) të LPP-së, i cili përcakton se: "*Organi përmbarues mund të konkludojë se natyra e kredisë kërkon trajtim të përshpejtuar të rastit nëse ka rrezik legjitim që pasuritë e debitorit në atë rast të mos jenë në dispozicion për konfiskim apo do t'i bie vlera shumë në rast të vonesës. Gjyqtari mund të pranojë ekzistimin e rrethanave të veçanta, dhe të veprojë shpejt, në rastet që kanë të bëjnë me punësimin, çështjet familjare, alimentacionin apo pagesat për fëmijë nëse interesat e palës mund të ndikohen negativisht si rezultat i vonesës.*"

52. Gjykata është e vetëdijshme që debitori mund të mos ketë pasur mjete financiare të mjaftueshme për përmbushjen e detyrimit ndaj djalit të tij dhe parashtrueses së kërkesës. Kjo është një arsye që ka ndikuar në kohëzgjatjen dhe pamundësinë e ekzekutimit të Aktgjykimit në favor të parashtrueses së kërkesës. Megjithatë, Gjykata thekson se gjykatat e rregullta, përveçse kishin dënuar me kusht debitorin për veprën penale "*Shmangia nga sigurimi i mjeteve të jetesës*", nuk duket që kishin ndërmarrë masa të tjera të mjaftueshme, të cilat do të mund të ishin të përshtatshme dhe të parashikuara me ligj për ekzekutimin e Aktgjykimit të formës së prerë. Kjo sjellje e autoriteteve përkatëse ka vazhduar deri në pjesën e dytë të vitit 2025, kur edhe kishin filluar të ndërmarrin veprime në drejtim të ekzekutimit të Aktgjykimit të formës së prerë. Për më tepër, gjykatat e rregullta as nuk kishin revokuar kushtin dhe nuk kanë shqiptuar dënimin me burgim ndaj debitorit, pavarësisht mosrealizimit të alimentacionit brenda periudhës së verifikimit nga ana e tij. Siç është reflektuar më lart, nga veprimi i fundit të gjykatave të rregullta e që konsiston në shpalljen fajtor të debitorit për veprën penale të lartcekur, deri në parashtrimin e kërkesës para Gjykatës, kanë kaluar 9 (nëntë) vjet e 3 (tre) muaj.

53. Parashtruesja e kërkesës parashtroi propozim për përmbarim në Gjykatën Themelore të Aktgjykimit të formës së prerë të po kësaj gjykate, si dhe kërkoi dy herë nga gjykatat e rregullta që të revokonin kushtin dhe të shqiptonin dënimin me burgim për debitorin, çka tregon se ajo u tregua aktive dhe ndërmori të gjitha hapat që i takonin me ligj për të ekzekutuar aktgjykimin. Për më tepër, Gjykata vlerëson se, në rastin konkret, natyra e kontestit ka të bëjë me pagesën e alimentacionit të djalit të mitur të parashtrueses së kërkesës, e cila nga shkresat e lëndës rezulton se është e papunë dhe mbahet nga familja e babait të saj, i cili tashmë kishte ndërruar jetë, me ç'rast edhe ishte përkeqësuar gjendja financiare e kësaj familjeje.

54. Marrë parasysh që (i) autoritetet shtetërore nuk u treguan aktive dhe nuk ndërmorën të gjitha masat e nevojshme dhe të parashikuara me ligj për ekzekutimin e Aktgjykimit të formës së prerë deri më 27 tetor 2025, gjegjësisht në parashtrimin e kërkesës nga ana e parashtrueses në Gjykatë; (ii) faktin se parashtruesja e kërkesës kishte ndërmarrë hapa konkretë për ekzekutimin e aktgjykimit; dhe se (iii) mosekzekutimi i Aktgjykimit e rëndoi gjendjen financiare të parashtrueses së kërkesës e rrjedhimisht të djalit të saj të mitur pasi që zbatimi i Aktgjykimit konsiston në pagesën e alimentacionit të fëmijës, Gjykata vlerëson se periudha prej më shumë se 9 (nëntë) vitesh për mosekzekutimin e Aktgjykimit të formës së prerë është e gjatë dhe e paarsyeshme dhe nuk është në përputhje me nenin 31 të Kushtetutës dhe nenin 6 të KEDNJ-së. Gjykata arriti në këtë konstatim pavarësisht veprimeve të ndërmarra nga Gjykata Themelore, të reflektuara në përgjigjen e saj të 20 shkurtit 2026, duke qenë se të njëjtat datojnë pas parashtrimit të kërkesës së parashtrueses në Gjykatë.

55. Gjykata konstaton se periudha prej më shumë se 9 (nëntë) vitesh prej se Aktgjykimi i formës së prerë i 18 dhjetorit 2013 të Gjykatës Themelore nuk u ekzekutua, është në kundërshtim me nenin 31 të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, përkitazi me të drejtën për ekzekutimin e vendimeve të formës së prerë.

56. Në fund, Gjykata rikujton se parashtruesja e kërkesës kërkon Gjykata që t'ia kompensojë dëmin jomaterial për shkak të dhimbjeve shpirtërore si pasojë e shkeljes së të drejtave të njeriut në shumën prej 10,000 (dhjetë mijë) eurosh. Në lidhje me këtë, Gjykata ka ripërsëritur se nuk ka autorizime ligjore për caktimin e ndonjë lloji të kompensimit për rastet në të cilat konstaton shkelje të Kushtetutës dhe KEDNJ-së (shih për shembull rastet e Gjykatës përkitazi me kohëzgjatjen e procedurave gjyqësore, KI142/23, parashtrues *Fadil Berisha*, cituar më lart, paragrafi 68, KI19/21, parashtrues *Sadik Pllana*, Aktgjykim i 18 korrikut 2022, paragrafi 115; KI06/21, parashtrues *Dragan Mihajlović*, Aktgjykim i 22 dhjetorit 2022;, paragrafi 84; dhe KI64/23, parashtruese *Mejrem Qehaja Rexha*, Aktgjykim i 31 gushtit 2023, paragrafi 104).

57. Gjykata rithekson se, në disa raste, gjetja e shkeljes kushtetuese paraqet një lloj të "*shpërblimit të drejtë*", sidomos kur parashtruesi ka mundur të pësojë dëm jomaterial. Megjithatë, individët mund të kërkojnë dëmshpërblim nga autoritetet publike në rast të konstatimit të shkeljes së të drejtave dhe lirive të tyre kushtetuese. Në rastet kur vetëm konstatimi i shkeljes nuk mjafton dhe kompensimi monetar është i domosdoshëm, individët kanë të drejtë të përdorin mjetet juridike në dispozicion për realizimin e të drejtave të tyre, përfshirë kompensimin e dëmit material dhe jomaterial pranë gjykatave të rregullta (shih rastet e Gjykatës: KI113/21, parashtruese *Bukurije Haxhimurati*, Aktgjykim i 20 dhjetorit 2021, paragrafët 145-151; dhe KI142/23, parashtrues *Fadil Berisha*, cituar më lart, paragrafi 69).

58. Në këtë kontekst, në rrethana të rastit konkret, Gjykata thekson se, pas këtij aktgjykimi nëpërmjet të cilit konstatohet shkelja e paragrafit 2 të nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me paragrafin 1 të nenit 6 të KEDNJ-së, gjykatat e rregullta duhet të ndërmarrin të gjitha hapat e nevojshëm për ta ekzekutuar Aktgjykimin [C. nr. 501/13] e 18 dhjetorit 2013 të Gjykatës Themelore në Gjakovë, me prioritet, dinamikë të shtuar dhe brenda një afati sa më të shpejtë kohor, konform gjetjeve të këtij Aktgjykimi.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me paragrafin 7 të nenin 113 të Kushtetutës, me nenet 20 dhe 47 të Ligjit, si dhe me rregullat 34 (1) dhe 48 (1) (a) të Rregullores së punës, më 12 maj 2026, njëzëri:

VENDOS

I. TA DEKLAROJË kërkesën të pranueshme;

II. TË KONSTATOJË që ka pasur shkelje të paragrafit 2 të nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, në lidhje me paragrafin 1 të nenit 6 (E drejta për një proces të rregullt) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, përkitazi me mosekzekutimin e Aktgjykimit [C. nr. 501/13] të 18 dhjetorit 2013 të Gjykatës Themelore në Gjakovë;

III. TA URDHËROJË Gjykatën Themelore në Gjakovë të ndërmarrë veprimet e nevojshme për të ekzekutuar Aktgjykimin [C. nr. 501/13] e 18 dhjetorit 2013 të Gjykatës Themelore në Gjakovë dhe ta informojë Gjykatën jo më vonë se 12 gusht 2026 për veprimet e ndërmarra;

IV. T'UA KUMTOJË këtë Aktgjykim palëve;

V. TA PUBLIKOJË këtë Aktgjykim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me paragrafin 4 të nenin 20 të Ligjit;

VI. Ky Aktgjykim hyn në fuqi në ditën e shpalljes në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës, në pajtim me paragrafin 5 të nenit 20 të Ligjit.

Gjyqtarja raportuese	**Kryetari i Gjykatës Kushtetuese**
Remzije Istrefi-Peci	Nexhmi Rexhepi